



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 3, Datë 08.04.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE TË INFRASTRUKTURËS PËR NDËRTIMIN E
RRJETIT TE FURNIZIMIT ME UJË DHE SHËRBIME SANITARE NË BASHKINË
ORIKUM, QARKU VLORË

Në mbështetje të neneve 6, 8, dhe 70/6 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore të Infrastrukturës për ndërtimin e rrjetit të furnizimit me ujë dhe shërbime sanitare në Bashkinë Orikum, Qarku Vlorë, me subjekt kërkues “(PMU) Njësia e Menaxhimit të Projekteve”, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.
2. Materiali i plotë grafik bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI



MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT



Z. EDMOND HAXHINASTO

MINISTËR I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS



SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

